



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Procesverbal -Tipi i kontrates -Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS – “Mirembajtje kanale vaditese ne Njesite Administrative”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
98341110-9 Sherbime mirembajtje

VLERA E FONDIT LIMIT – 4 036 900 (kater milion e tridhjet e gjashte mije e nenteqind) **leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. 160/2020 "Per prokurimin publik" neni 77, pika 3, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 43 pika 2 dhe 3.

Përcaktimi i vitit të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e xhiros vjetore financiare është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e

shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë licencat e tipit N.P-1/A .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.neni 41 pika 4 germa a.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për të kryer veprimtarin profesionale, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P – 1 A	Punime Germimi	Percaktimet ne preventiv	A

2.3.3 Operatori Ekonomik per realizimin e kontrates duhet te disponoje:

- Teknik i mesem mdertimi/topograf pjese e stafit teknik te shoqerise me deshmi kualifikimi, kontrate pune
- Vegla pune dore (kazma dhe lopata) 17+17 cope
- Jelek identifikues 16 (gjashtembedhjet) cope
- Puntore te thjeshte 16 (gjashtembedhjete)

Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar **16** puntore te thjeshte dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41 pika 4 germa c.

Numeri i punonjesve te thjeshte eshte ne funksion te volumit total te germimeve qe eshte 2600 m². meqenese nje puntor mesatarisht ne dite pune leviz rreth 5 m² material per kryerje e punimeve nevoiten 520 dite pune. Meqenese afati i punimeve eshte 45 dite kalendarike ose 33 dite pune per sasine 520 dite pune nevoiten 16 punonjes.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.